



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit

SP-095

Prishtinë, më 30, 31 mars dhe 11 prill 2017

P R O C E S V E R B A L

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 30, 31 MARS DHE 11 PRILL 2017**

Seancën e drejtoi kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, i ndihmuar nga nënkryetarët Sabri Hamiti dhe Aida Dërguti.

Kryetari i hapi punimet e kësaj seance plenare sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, në mbledhjen e mbajtur më 27 mars 2017.

Para se të procedohet me rendin e ditës, për fjalë u paraqitën deputetët Nait Hasani dhe Muhamet Mustafa.

Nait Hasani, kryetar i Komisionit FunkSIONAL për Arsim, propozoi që nga rendi i ditës të hiqet shqyrtimi i parë i Projektligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës dhe i njëjti të kthehet në komision për rishqyrtim.

Për propozimin e deputetit Nait Hasani diskutuan: Salih Morina, në emër të GP të LDK-së, Ismajl Kurteshi, në emër të GP të LVV-së, Teuta Haxhiu, në emër të GP të AAK-së, Enver Hoti, në emër të GP “Nisma”, Slavko Simiq, në emër të GP të LS-së, Mufera Shinik, në emër të GP “6+” dhe ministri Arsim Bajrami, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim propozimin e lartshënuar.

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për -----42,
Kundër -----22,
Abstenime ----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi vendosi që Projektligji për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës të hiqet nga rendi i ditës të seancës së sotme dhe t'i kthehet Komisionit Funksional.

Kryetari i Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Muhamet Mustafa, propozoi që rendi i ditës të plotësohet me Shqyrtimin e parë të Projektligjit për shoqëritë tregtare.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e lartshënuar.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për -----50,
Kundër ----- 9,
Abstenime ----- 9.

Kryetari konstatoi se Kuvendi vendosi që Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-158 për shoqëritë tregtare të radhitet në rend dite të kësaj seance.

Më pas, kryetari procedoi me pikat e rendit të ditës, si në vijim:

1. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni Funksional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Në mungesë të përfaqësuesit të Qeverisë, kryetari e ftoi kryetarin e Komisionit Funksional për Integritet Evropian, z. Elmi Reçica, ta paraqesë raportin me rekomandim.

Pas raportimit të z. Reçica, kryesimin e seancës e mori nënkryetari Sabri Hamiti, i cili e hapi debatin rreth këtij projektligji.

Për këtë projektligj diskutuan: Puhie Demaku, Zafir Berisha, Enver Hoxhaj, Vjosa Osmani, Daut Haradinaj, Qerim Bajrami, Zenun Pajaziti, Glauk Konjufca, Sabri Hamiti, Ilir Deda, Faton Topalli dhe Ismajl Kurtishi, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Për harmonizimin e një qëndrimi të përbashkët rreth kësaj çështjeje u dha një pauzë për konsultime në mes të grupeve parlamentare.

Pas pauzës, deputetja Vjosa Osmani, në emër të grupit punues për harmonizimin e qëndrimeve, e paraqiti tekstin e deklaratës të harmonizuar nga grupet parlamentare: PDK, LDK, LVV, AAK, “Nisma” dhe “6+”.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim propozim-deklaratën.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----	80,
Kundër -----	5,
Abstenime -----	0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi këtë:

D E K L A R A T Ë

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës e njeh Kosovën vetëm në bazë të emrit të saj kushtetues si Republikë e Kosovës,
2. Në përputhje me nenin 18 të Kushtetutës, të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare ratifikohen me ligj që i referohet Kosovës sipas emrit të saj kushtetues dhe
3. Kjo deklaratë do t’i bashkëngjitet secilës marrëveshje ndërkombëtare, e cila ratifikohet në Kuvend nga sot e tutje.

* * *

Në vazhdim, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----	89,
Kundër -----	2,
Abstenime -----	0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 05/L-137 për ratifikimin e Marrëveshjes përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për themelimin e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor ndërmjet Kosovës, Shqipërisë, Bosnjë e Hercegovinës, Malit të Zi, Maqedonisë dhe Serbisë

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që ta paraqesë dhe ta arsyetojë këtë projektligj.

Ministri i Punëve të Jashtme, z. Enver Hoxhaj, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Kryetari i Komisionit FunkSIONAL për Arsim, Nait Hasani, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Për projektligjin diskutuan deputetët: Teuta Haxhiu dhe Qerim Bajrami, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesuesi e hodhi në votim projektligjin e lartshënuar.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----	82,
Kundër -----	10,
Abstenime -----	1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 05/L-149 për ratifikimin e Marrëveshjes për themelimin e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor ndërmjet Kosovës, Shqipërisë, Bosnjë e Hercegovinës, Malit të Zi, Maqedonisë dhe Serbisë.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-151 për ratifikimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për shkëmbimin dhe/ose ndarjen e rezervës rregulluese ndërmjet operatorit të sistemit të transmetimit OST sh. a. dhe operatorit të sistemit, të transmisionit dhe tregut-KOSTT sh. a.

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik e ka shqyrtuar dhe i ka rekomanduar Kuvendit miratimin e projektligjit me një amendament.

Ministri për Zhvillim Ekonomik, z. Blerand Stavileci, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Kryetari i Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Muhamet Mustafa, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Kryesuesi e hodhi në votim amendamentin e vetëm të propozuar nga Komisioni FunkSIONAL.

Rezultati ishte, si në vijim:

Për ----- 91,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se miratohet amendamenti i propozuar nga Komisioni FunkSIONAL.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim projektligjin si tërësi me amendamentin e miratuar.

Rezultati ishte, si në vijim:

Për ----- 93,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 05/L-151 për ratifikimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për shkëmbimin dhe/ose ndarjen e rezervës rregulluese ndërmjet operatorit të sistemit të transmetimit OST sh. a. dhe operatorit të sistemit, të transmisionit dhe tregut - KOSTT sh.a.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-157 për ratifikimin e marrëveshjes së financimit të projektit për sigurinë e ujit dhe mbrojtjen e kanalit, e nënshkruar ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Ministri i Financave, z. Avdullah Hoti, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Kryetari i Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, Naser Osmani, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Për këtë projektligjin diskutuan: Shqipe Pantina, Besim Beqaj, Muhamet Mustafa, Daut Haradinaj dhe Hajdar Beqaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim projektligjin si tërësi me përmirësimin e propozuar.

Rezultati ishte, si në vijim:

Për ----- 81,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 05/L-151 për ratifikimin e marrëveshjes së financimit për sigurinë e ujit dhe mbrojtjen e kanalit të Ibër-Lepencit, e nënshkruar ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-158 për shoqëritë tregtare

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Ministrja e Tregtisë dhe Industrisë, znj. Hykmete Bajrami, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Ajo i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji.

Lidhur me projektligjin diskutuan: Muhamet Mustafa, në emër të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Sala Berisha-Shala, në emër të GP të PDK-së, Blerim Grainca, në emër të GP të LDK-së, Teuta Haxhiu, në emër të GP të AAK-së dhe deputeti Shaip Muja, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesuesi e hodhi në votim projektligjin e lartshënuar.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 56,
Kundër ----- 5,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 05/L-158 për shoqëritë tregtare.

2. Ngarkohen Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndërmarrjet sociale

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Ministrja e Tregtisë dhe Industrisë, znj. Hykmete Bajrami, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Ajo i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji në parim.

Lidhur me Projektligjin për ndërmarrjet sociale diskutuan: Flora Brovina, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Shëndetësi dhe në emër të GP të PDK-së, Salih Morina, në emër të GP të LDK-së, Faton Topalli në emër të GP të LVV-së, Teuta Haxhiu, në emër të GP të AAK-së, si dhe deputetet Njomza Emini e Shqipe Pantina, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesuesi e hodhi në votim projektligjin e lartshënuar.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 62,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 05/L-148 për ndërmarrjet sociale.
2. Ngarkohen Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-138 për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL e ka hartuar Projektligjin për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz dhe Kuvendit i ka rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin e tij.

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Komisionit FunkSIONAL që ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Deputeti Salih Salihu para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji në parim.

Lidhur me projektligjin diskutuan: Salih Salihu, në emër të Komisionit FunkSIONAL, Shaip Muja, në emër të GP të PDK-së, Murat Hoxha, në emër të GP të LDK-së, Glauk Konjufca, në emër të GP të LVV-së, Teuta Haxhiu, në emër të GP të AAK-së, Haxhi Shala, në emër të GP “Nisma”, si dhe deputetët Melihate Tërmkolli, Sala Berisha-Shala, Abdyl Ymeri, Bekim Haxhiu dhe nënkryetari Sabri Hamiti, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesuesi e hodhi në votim projektligjin e lartshënuar.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----	58,
Kundër -----	1,
Abstenime -----	6.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 05/L-138 për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz.
2. Ngarkohen Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

E premte, më 31 mars

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 30 mars

Mbledhjen e drejtoi nënkryetarja e Kuvendit, znj. Aida Dërguti

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-142 për mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguria bërthamore

Kryesuesja i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, z. Ferat Shala, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesja e hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji në parim.

Lidhur me projektligjin diskutuan: Salih Salihu, në emër të Komisionit Funkcional dhe në emër të GP të LVV-së, Shaip Muja, në emër të GP të PDK-së, Adem Salihaj, në emër të GP të LDK-së, Bali Muharremaj, në emër të GP të AAK-së dhe Haxhi Shala, në emër të GP “Nisma”, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesuesi e hodhi në votim projektligjin e lartshënuar.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----	70,
Kundër -----	0,
Abstenime -----	0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 05/L-142 për mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguria bërthamore.
2. Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

9. Votimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për minierat dhe mineralet, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-158

Kryesuesja i njoftoi deputetët se diskutimet për këtë projektligj kanë përfunduar në seancat e kaluara. Por, në mungesë të kuorumit për vendimmarrje votimi i këtij projektligj është riproceduar për seancën e sotme.

Kryesuesja e hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për minierat dhe mineralet, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-158.

Kryesuesja konstatoi se nuk pati kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

* * *

Votimi i këtij projektligj është proceduar edhe në seancën plenare të mbajtur më 11 prill 2017, por nuk ka pasur kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-129 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/ L-149 për ekzekutimin e sanksioneve penale

Kryesuesja i njoftoi deputetët se diskutimet për këtë projektligj kanë përfunduar në seancat e kaluara, por në mungesë të kuorumit për vendimmarrje votimi i këtij projektligj është riproceduar për seancën e sotme.

Kryesuesja i hodhi në votim veç e veç amendamentet sipas radhitjes së Komisionit FunkSIONAL.

Kuvendi nuk e miratoi amendamentin nr. 1, të propozuar nga deputeti Nait Hasani.

Pastaj, kryesuesja procedoi me votimin e amendamentit 2, të propozuar nga Komisioni FunkSIONAL. Por, nuk pati kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje. Votimi i këtyre amendamenteve u shty për seancën e radhës.

* * *

Në seancën plenare të mbajtur më 11 prill 2017 amendamentet prej 2-15 të këtij projektligji janë riproceduar për votim, por nuk ka pasur kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-134 për legalizimin e armëve dhe dorëzimin e armëve të vogla dhe të lehta, municionit dhe mjeteve eksplozive

Kryesuesi i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij.

Kryetari i Komisionit FunkSIONAL për Punë të Brendshme, z. Daut Haradinaj, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin me rekomandime.

Në projektligj ishin propozuar 17 amendamente nga Komisioni FunkSIONAL.

Kryesuesja i hodhi në pako për votim amendamentet e propozuara. Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16 dhe 17.

Pastaj kryesuesi i hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 75,
Kundër ----- 0,
Abstenime -----1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 05/L-134 për legalizimin dhe dorëzimin e armëve, municionit dhe mjeteve eksplozive.

12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-091 për mbrojtjen nga zhurma

Kryesuesi i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij.

Deputetja Duda Balje propozoi që ky projektligj, për shkak të disa lëshimeve, të procedohet për lexim të tretë.

Lidhur me këtë projektligj diskutuan: Zenun Pajaziti, në emër të GP të PDK-së, Salih Morina, në emër të GP të LDK-së, Albulena Haxhiu, në emër të GP të LVV-së, Bali Muharremaj, në emër të GP të AAK-së, Mufera Srbica-Shinik, në emër të GP “6+”, të cilët e përkrahën propozimin e kryetares së Komisionit Funksional që projektligji të shkojë në lexim të tretë.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi i hodhi në votim amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional, por nuk kishte kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-127 për plotësimin e Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Kryesuesi i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij.

Në projektligj nuk ishte propozuar asnjë amendament.

Kryesuesi e hodhi në votim tekstin e projektligjit.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 55,
Kundër ----- 9,
Abstenime -----4.

Kryesuesja konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 05/L-127 për plotësimin e Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

14. Votimi i Propozim-rezolutës në lidhje me arrestimet e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Kuvendi në seancën e mbajtur më 9 shkurt 2017 ka votuar për këtë rezolutë, por nuk ka pasur kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

Kryesuesi e hodhi në votim propozim-rezolutën, por nuk kishte kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

15. Votimi për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një anëtari të Bordit të Radio Televizionit të Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar i LVV-së dhe Grupi Parlamentar i LS-së nuk i kanë propozuar anëtarët për Komisionin ad hoc për përzgjedhjen e një anëtari të Bordit të Radio Televizionit të Kosovës. Kryesuesi i ftoi që t'i propozojnë anëtarët e këtij komisioni.

Pas propozimeve të bëra nga grupet parlamentare, kryesuesi e hodhi në votim formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një anëtari të Bordit të Radio Televizionit të Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 68,
Kundër ----- 0,
Abstenime -----2.

Kryesuesja konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Formohet Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Bordit të Radio Televizionit të Kosovës, në këtë përbërje:

1. Blerta Deliu nga GP i PDK-së, kryesuese,
2. Jelena Bontiq, nga GP i LS-së, zv. kryesuese e parë,
3. Sadri Ferati, nga GP LDK-së, zv. kryesues i dytë,
4. Xhevahire Izmaqu, nga GP i PDK-së, anëtare,
5. Agim Kikaj, nga GP i LDK-së, anëtar,
6. Mytaher Haskuka, nga GP i LVV-së, anëtar,
7. Lahi Brahimaj, nga GP i AAK-së, anëtar,
8. Kujtim Paçaku, nga GP “6+”, anëtar,
9. Zafir Berisha, nga GP “Nisma”, anëtar.

1. Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e formoi Komisionin për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Bordit të Radio Televizionit të Kosovës.

2. Komisioni ad hoc, në bazë të nenit 26, pika 2.3 të Ligjit nr. 04/L-046 për Radio Televizionin e Kosovës, duhet t'i shqyrtojë dhe t'i përzgjedhë kandidaturat e paraqitura për anëtar të Bordit të Radio Televizionit të Kosovës dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

16. Zgjedhja e 1 (një) anëtari të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga radha e komunitetit serb

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për Legjislacion i ka zhvilluar procedurat për përzgjedhjen e 1 anëtari të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës nga radhët e komunitetit serb dhe Kuvendit i ka rekomanduar zgjedhjen e njërit prej kandidatëve të propozuar, si në vijim:

- Radojka Trifunoviq dhe
- Ivica Ivanoviq.

Deputetja Albulena Haxhiu, në emër të Komisionit FunkSIONAL e paraqiti raportin e komisionit për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës.

Deputetja Albulena Haxhiu, në emër të GP të LVV-së, deklaroi se asnjëri konditat nuk i plotëson kushtet për t'u zgjedhur anëtar i Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës.

Kryesuesi kërkoi nga grupet parlamentare që ta propozojnë nga një anëtar për formimin e Komisionit votues.

Kuvendi, me propozimin e grupeve parlamentare, mori këtë:

V E N D I M

Për formimin e Komisionit votues, në këtë përbërje:

1. Abdyl Ymeri, nga GP i PDK-së,
2. Murat Hoxha, nga GP i LDK-së,
3. Mytaher Haskuka, nga GP i LVV-së,
4. Sasha Milosavljeviq, nga GP i LS-së,
5. Haxhi Shala, nga GP "Nisma",
6. Qerim Bajrami, nga GP "6+".

Pastaj, kryesuesi i ftoi deputetët një nga një që të votojnë.

Pas zhvillimit të procedurave të votimit dhe numërimit të rezultateve të votimit, raportin e Komisionit votues e paraqiti deputeti Abdyl Ymeri.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Në votim kanë marrë pjesë 69 deputetë, të pavlefshme kanë qenë 15 fletëvotime.

Kandidatja Radojka Trifunović i ka fituar 46 vota,
Kandidati Ivica Ivanović i ka fituar 8 vota.

Kryesuesi konstatoi se asnjëri nga kandidatët nuk i ka marrë votat e nevojshme për t'u zgjedhur anëtar i KGJK-së. Andaj, duhet të procedohet me rundin e dytë të votimit.

* * *

E martë, 11 prill 2017

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 30 dhe 31 mars

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.

Rundi i dytë i votimit për zgjedhjen e një (1) anëtari të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga radha e komunitetit serb është zhvilluar në seancën plenare të mbajtur më 11 prill 2017.

Kryesuesi i seancës i ftoi deputetët një nga një që të votojnë.

Pas zhvillimit të procedurave të votimit në rundin e dytë dhe numërimit të votave për zgjedhjen e një (1) anëtari të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga radha e komunitetit serb, raportin e Komisionit votues e paraqiti deputeti Abdyl Ymeri.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Në votim kishin marrë pjesë 65 deputetë, të pavlefshme ishin 8 fletëvotime.

Kandidatja Radojka Trifunović i ka fituar 51 vota,
Kandidati Ivica Ivanović i ka fituar 6 vota.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e zgjodhi znj. Radojka Trifunović anëtare të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës nga radha e komunitetit serb, me mandat pesëvjeçar.

Kryesuesi i mbylli punimet e seancës plenare në orën 13:15 minuta.

Kryetari i Kuvendit:

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale

(Procesverbali nuk është miratuar për shkak të shpërndarjes së Kuvendit)